



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORE

Nr.Rregj.Them. 383

Data e ardhjes 20.08.2013

Nr. Vendimi 383

Data 22.08.2013

V E N D I M
“Ne emer te Republikes”

Gjykata e rrethit gjyqesor Vlore e perberc nga;

Klodiana Gjyzari- Gjyqtare

Asistuar nga sekretarja e seances gjyqesore Elona Shaqiraj, sot me 22.08.2013, ora 11/30, ne Vlore ne seance gjyqesore publike, mori ne shqyrtim ceshtjen penale nr. 383, qe i perket:

KERKUES: Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, perfaqesuar nga prokuret [REDACTED]

OBJEKTI: - Konfiskim mjeti lundrues.

Baza ligjore: nen 23/3 dhe 24 i ligjit nr. 8663 date 18.09.2000

“Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nen 20 NT”

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses, pasi degjoi prokurorin, i cili perfundimisht kerkoi pranimin e kerkeses, si dhe shqyrtoi aktet ne teresi:

V E R E N

Se, prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, ka paraqitur prane kesaj gjyke kerkesen per konfiskimin e mjetit lundrues gomone e cila ne date 16.08.2013 eshte sekuestruar nga sherbimet e policise gjyqesore te Drejtorese se Policise Vlore.

Nga procesverbali i sekuestrit te proves materiale dt. 16.08.2013 rezulton se nga ana e policise gjyqesore ne vendin e quajtur “Aulona” eshte konstatuar nje mjet lundrues I llojit “gomone” se bashku me karrelin. Ne kic, pjesen fundore te mjetit ne qender te tij eshte

konstatuar I montuar nje motor voribord, me helik, me mbishkrimin "EVINRUDE". Ne kapakun e siperim te motorrit gjendet nje numer 60. Mjeti lundrues ka patur permasat 5.8x2.3meter.

Mjeti lundrues ka qene ne posedim te shtetasit [REDACTED] cili ka deklaruar se perkiste shtetasit [REDACTED] cili kishte dhe dokumentacionin perkates. Mjeti lundrues I mesiperim eshte sekuestruar pasi ne kete mjet nuk eshte gjetur asnjë dokument per identifikimin e pronareve apo poseduesve te tij.

Bazuar ne nenin 5 te ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdomit dhe kontrollin e mijeteve lundruese me motor me tonazh nen 20 NT"

"Mjetet lundruese, objekti i këtij ligji, duhet të jenë në çdo rast:
a) të matrikulluara në kapitanerinë e portit ose në zyrat që varen prej saj, përgjegjëse për territorin, dhe që ndodhen pranë ligeneve e lumenjve;
b) të regjistruara në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin."

Nga procesverbal I kqyrjes se mjetit lundrues dhe procesverbal I sekuestrimit te tij nuk rezultoi te ishte I matrikulluar ne kapitenerine e portit apo ne zrat qe varen prej saj.

Bazuar ne nenin 12 te ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdomit dhe kontrollin e mijeteve lundruese me motor me tonazh nen 20 NT"

1. Cilido që zotëron ose mban, me çfarëdolloj titulli, një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarimin me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje, në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vendbazimin e përhershëm të mjetit, si dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.
2. Zotëruesi ose mbajtësi duhet të mbajnë gjithmonë me vete dokumentet që dëshmojnë matrikullimin dhe regjistrimin e mjetit lundrues.
3. Deklarimi i zotërimit ose i mbajtjes duhet të bëhet sa herë ndryshon vendbazimi i përhershëm i mjetit.

Nga aktet procesverbal I sekuestrimit dhe procesverbal I kqyrjes se mjetit lundrues nuk rezultoi te dorezoheshin prane oficerit te policise gjyquesore prej shtetasit qe e posedonte mjetin lundrues dokumentacion ne lidhje me titullin ne baze te te cilit ai posedonte mjetin lundrues.

Bazuar ne nenin 23 te ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdomit dhe kontrollin e mijeteve lundruese me motor me tonazh nen 20 NT" mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes, siç parashikohet në nenin 12, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.

Sipas paragrafit te dyte te ketij neni oficeri ose agjentit i policise kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

Keto veprime te oficerit ose agjentit te policise kufitare verifikohen nga Gjykata, e cila brenda 15- (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Bazuar ne nenin 24 te ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruesc me motor me tonazh nen 20 NT", pronësia, mbajta ose zotërimi i një mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, të pamatrikulluar ose të paregjistruar, sipas nenit 5, përbën kundervajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë), deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues. Sipas paragrafit te dyte te ketij neni oficeri ose agjentit i policise kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

Keto veprime te oficerit ose agjentit te policise kufitare verifikohen nga Gjykata, e cila brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Sipas dy dispozitave te cituara me lart, veprimet e policise gjyqesore janë te peraktuara ne nenin 31 te ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nen 20 NT", sipas paragrafit te dyte te te cilit "oficeri i policise gjyqesore mund të veprojë me nismën e vet në rastet e flagrancës, sipas kriterieve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale".

Gjykata cionon veprimet e policise gjyqesore ne rastin e sekuestrimit te mjetit lundrues te dates 16.08.2013 janë kryer ne perputhje me ligjin. Rezulton qe kane qene kushtet e flagrancës dhe oficeri i policise gjyqesore ka vepruar sipas kushteve te parashikuara ne nenin 31/2 I ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nen 20 NT". Rezulton se bazuar ne nenet 5 dhe 12 te ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nen 20 NT" mjeti lundrues I konstatuar I ploteson kushtet e parashikuara nga ligji per te kryer regjistrimin e detyrueshem te tij detyrim I cili nuk eshte zbatuar nga shtetasit te cilid e kishin ne posedim.

Bazuar ne nenin 5, dhe 12-ne lidhje me nenet 23 dhe 24 te ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nen 20 NT" shkelja e detyrimeve te peraktuara ne nenet 5 dhe 12 te ligjit nr.8663 date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruesc me motor me tonazh nen 20 NT" perben kundervajtje penale dhe shoqerohet vec sanksonit penal dhe me konfiskimin e mjetit lundrues te sekeustraur. Bazuar ne sa me lart gjykata cionon se kerkesa e prokurorit per konfiskimin e mjetit lundrues te sekuestruar nga policia gjyqesore sipas procesverbalit te dates 16.08.2013 do te pranohet.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenet 5, 12, 23/3, 24/3, 31 te ligjit nr. 8663 date 18.09.2000 "Per rregjistrimin, klasifikimin, menyren e perdomit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT"

VENDOSI

1. Konfiskimin e mjetit lundrues tip gomone me gjatesi 5.8 x 2.3 meter me nje motor te instaluar, me mbishkrinin "EVINRUDE", ne kapakun e siperm te te cilit gjendet nje numer 60.
2. Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.
3. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Vlore brenda afatit 10 ditor nga e nesermja e shpalljes.

Vlore me 22.08.2013

Sekretare
Elona Shaqiraj

Gjyqtare
Klodiana Gjyzari

